

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
RETAIL PARK SH.P.K.  
ME SELI NË : "RRUGA LUIJ GURAKUQI, PALLATI 89, SHK.1, AP.33, TIRANË, SHQIPËRI  
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR IDENTIFIKIMI  
L71515042Q

---

VENDIMI

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 10.11..2020, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë "Retail Park" Sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në "Rruga Luigj Gurakuqi, pallati 89, shk.1, ap.33, Njësia Bashkiake nr. 2, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

1. **"Balfin" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kat 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("Ortaku i Vetëm").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Itena Ndraqi, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

I. **ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRINË RETAIL PARK SH.P.K.**


\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja operacionale të Shoqerisë kërkohet financimin i saj me një shumë prej 3,000,000 LEK (tre milion lekë), Financimi do të jepet në formën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë i cili nga 1,500,100 LEK (një milion e pesë qind mijë e një qind lekë), do të zmadhohet në 4,500,100 LEK (katër milion e pesë qind mijë e një qind lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdeshshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë Retail Park sh.p.k. (NUIS: L71515042Q ) me LEK 3,000,000 LEK (tre milion lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nëshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetem në para.




- C. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga 1,500,100 LEK (një milion e pesë qind mijë e një qind lekë) do të bëhet 4,500,100 LEK (katër milion e pesë qind mijë e një qind lekë);
- D. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjeter për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.


\*\*\*\*\*

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË  
RETAIL PARK SH.P.K.**

**KRYETAR**

  
Edlira Muka  
Retail Process Management Group  
ZNJ. EDLIRA MUKA

**SEKRETAR**

  
Itena Ndroqi  
ZNJ. ITENA NDROQI